



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

GJYKATA THEMELORE PRIZREN

Numri i lëndës: 2023:174295
Datë: 28.03.2024
Numri i dokumentit: 05515525

CP.nr.992/2023

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN, Departamenti i Përgjithshëm, Gjyqtari Sami Gashi, në çështjen juridike përmbartimore të kreditorit S.T., nga Prizreni rr”.....,” nr....., e cila në këtë procedure përfaqësohet me autorizim nga avokat F.S., nga Prizreni, kundër debitorit, Agjencia Kosovare e Privatizimit (AKP) Zyra Rajonale në Prizren, në bazë të dokumentit përmbartimor-aktgjykimi i Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës C-IV-13-2669 të datës 07.12.2021, dhe aktgjykimi i Kolegjit të Apelit të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës AC-I-21-0850 i datës 10.11.2022, lejuar me aktvendimin e kësaj gjykate CP.nr.992/2023 të dt.17.08.2023, duke vendosur sipas prapësimit të debitorit, jashtë seancës dëgjimore, me datën 28.03.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

I. PRANOHET tërësisht si i bazuar prapësimi i Agjencisë Kosovare të Privatizimit (AKP) - Zyra Rajonale në Prizren, i ushtruar kundër aktvendimit CP.nr.992/2023 të dt.17.08.2023, të Gjykatës Themelore në Prizren, dhe se ky Aktvendim për përmbartim, Anullohet - Shfuqizohet tërësisht.

II. PEZULLOHET procedura në këtë çështje juridike përmbartimore CP.nr.992/2023, dhe UDHËZOHET, kreditorja e përmbartimit, S.T., nga Prizreni, që nga kredia e përcaktuar në dokumentin përmbartimor - aktgjykimi i Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës C-IV-13-2669 të datës 07.12.2021, dhe aktgjykimi i Kolegjit të Apelit të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës AC-I-21-0850 i datës 10.11.2022, për shkak të detyrimit në të holla në shumën prej 2,063.95 €, t’u realizoj pranë Autoritetit të Likuidimit i cili është në kuadër të Agjencisë Kosovare të Privatizimit (AKP) në Prishtinë, dhe:

III. Secila palë i bart shpenzimet e procedurës së përmbartimit në këtë çështje juridike të përmbartimit.

A r s y e t i m

Gjykata Themelore në Prizren, me aktvendimin CP.nr.992/2023 të dt.17.08.2023 ka lejuar propozimin për përmbarim të kreditorit, S.T., nga Prizreni, e cila në këtë procedure përfaqësohet me autorizim nga avokat F.S., nga Prizreni, të paraqitur kundër debitorit, Agjencia Kosovare e Privatizimit (AKP) Zyra Rajonale në Prizren, në bazë të dokumentit përmbarues- aktgjykimi i Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës C-IV-13-2669 të datës 07.12.2021, dhe aktgjykimi i Kolegjit të Apelit të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës AC-I-21-0850 i datës 10.11.2022, për shkak të detyrimit në të holla në shumën prej 2,063.95 €, me kamatë ligjore prej 8% prej datës së plotfuqishmërisë së aktgjykimit të datës 10.11.2022, si dhe shpenzimet e procedurës përmbarimore.

Kundër aktvendimit mbi lejimin e përmbarimit, i autorizuari i debitorit, në afatin ligjor ka paraqitur prapsim, për shkak se aktvendimi mbi lejueshmërinë e propozimit të kreditorit është marrë në kundërshtim me dispozitat ligjore, me propozim që të shfuqizohet propozimi i kreditorit për fillimin e procedurës së ekzekutimit ndaj debitorit, për shkak se N.SH “Komuna” me vendimin e Bordit të Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit të datës 06.03.2008 është në procedurë të likuidimit, me tej ka shtuar se duke u bazuar në ligjin nr.04/L-034 shtojcës së ligjit neni 10.1 parashihet pezullimi ndërprerja e të gjitha procedurave duke përfshirë edhe procedurën e përmbarimit, ndaj një ndërmarrje që është subjekt i likuidimit, e për më tepër si në arsyetimin e këtij prapësimi.

I autorizuari i kreditorit av. F.S., nga Prizreni, ka paraqitur përgjigje në prapsim, duke i kundërshtuar në tërësi kundërshtimin e debitorit, duke theksuar se propozimi për përmbarim i vendimit gjyqësor është bërë në përputhje të plotë me nenin 38 të LPP-së, kërkesa e debitorit është në kundërshtim me nenin 40 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit pasi që procedurat e likuidimit të kërkesave të kreditorëve do të përmbushen në pajtim me kategoritë dhe sipas renditjes të përcaktuar me ligjin për AKP, përfshirë këtu kërkesat për pagat e punonjësve të cilat nuk janë paguar deri në datën e vendimit nga gjykata, me propozim që të refuzohet si i pabazuar kundërshtimi i debitorit dhe të vazhdohet me procedurën e përmbarimit.

Gjykata Themelore në Prizren me aktvendimin CP.nr.992/2023 të datës 24.10.2023 ka vendosur si në vijim: I. REFUZOHET si i pa bazuar prapësimi i debitorit, Agjencia Kosovare e Privatizimit (AKP) –Zyra Rajonale në Prizren, i paraqitur kundër aktvendimit të Gjykatës Themelore në Prizren CP.nr.992/2023 të dt.17.08.2023, dhe i njëjti aktvendim për përmbarim, MBETET NË FUQI.

Ndaj aktvendimit CP.nr.992/2023 të datës 24.10.2023, debitori në afatin ligjor ka paraqitur ankesës, për shkak të zbatimit të gabuar të së drejtës materiale dhe vërtetim të gabuar të gjendjes faktike, me propozim që të aprovohet ankesa si e bazuar në ligj dhe që të pezullohet kjo procedurë e përmbarimit.

I autorizuari i kreditorit ka paraqitur përgjigje në ankesë të debitorit, duke e kundërshtuar ankesën e debitorit, të paraqitur kundër aktvendimit të kësaj gjykate, e me propozim që ankesa e debitorit të refuzohet në tërësi si e pabazuar dhe aktvendimi CP.nr.992/2023 i datës 24.10.2023 të vërtetohet.

Gjykata e Apelit e Kosovës në Prishtinë, me aktvendimin CAP.nr.1624/2023 të datës 11.03.2024, ka vendosur si në vijim: Aprovohet si e bazuar ankesa e debitorit Agjencia Kosovare e Privatizimit (AKP) Zyra Rajonale në Prizren, Anulohet aktvendimi i Gjykatës Themelore në Prizren-Departamenti i Përgjithshëm, CP.nr.992/2023 të datës 24.10.2023, dhe lënda i kthehet gjykatës së shkallës së parë në procedim të serishëm.

Kjo gjykatë në ri procedim të kësaj çështje përmbarimore, pas shqyrtimit të gjitha shkresave të lëndë, ka vlerësuar se prapësimi i palës debitore, pranohet tërësisht si i bazuar dhe se duhet të bëhet pezullimi i procedurës së përmbarimit në këtë çështje juridike të përmbarimit dhe se pala kreditore, duhet të udhëzohet që detyrimin në të holla, t'a kërkon te Autoriteti i Likuidimit pranë AKP-së me seli në Prishtinë dhe atë për këtë arsye :

Pasi që debitori ka ushtruar prapësim kundër aktvendimit të kësaj gjykate CP.nr.992/2023 të datës 24.10.2023, e me arsyet e cekura si në këtë prapësim, e këtij prapësimi ia ka bashkangjitur, shkresën nga e cila provohet se pala debitore NSH Komuna me vendim të Bordit të Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit, të datës 06.03.2008 është në procesin e Likuidimit, e në kuadër të pezullimit të procedurës së përmbarimit në një çështje juridike të përmbarimit, si në rastin konkret, bëhet fjalë në nenin 10 të Shtojcës së Ligjit të Agjencisë Kosovare të Privatizimit, që i referohet Pezullimit të veprimeve, e në të cilin, thuhet se: *'Çdo veprim gjyqësor, administrativ apo i arbitrazhit, procedurë apo akt që përfshin apo që është kundër një ndërmarrje (apo asetëve të saj) që është subjekt i Vendimit për Likuidim pezullohet pas parashtrimit të njoftimit të Vendimit për Likuidim nga ana e Autoritetit të Likuidimit në gjykatën përkatëse, autoritetin publik apo tribunalin e arbitrazhit. Ky njoftim i referohet këtij neni 10 dhe shoqërohet me një kopje të Vendimit për Likuidim dhe një kopje të Njoftimit të publikuar për likuidim''*.

Ndërsa me Udhëzimin C-IV-15 - 1607 të dt.15.10.2015, të Kolegjit të Specializuar të Gjykatës Supreme të Kosovës-Dhomës së Posaçme, dhe me udhëzimin Juridik të Gjykatës Supreme të Kosovës i datës 27.02.2023, në pikën e I përcaktohet se, nga data e parashtrimit të njoftimit të Vendimit për Likuidim, e deri në përfundimin e likuidimit pezullohet çdo procedurë gjyqësore administrative apo e arbitrazhit që është kundër ndërmarrjes dhe asetëve të saj që është subjekt i Vendimit për Likuidim, përfshirë edhe procedurën përmbarimore, andaj edhe me arsyet e cekura më lartë, kjo gjykatë e pranoj në të tërësi prapësimin e palës debitore të ushtruar kundër aktvendimit CP.nr.992/2023 të datës 17.08.2023 dhe të njëjtin aktvendimin për përmbarim, e Anuloj - Shfuqizoj tërësisht, si dhe konsideroj se në këtë rast, janë plotësuar kushtet ligjore që në këtë çështje juridike të përmbarimit, të bëhet Pezullimi i procedurës së përmbarimit, kurse kreditorja kredinë e saj në të holla të përcaktuar në dokumentin përmbarimor, udhëzohet që në kuptim të nenit 7 dhe nenit 23 të Shtojcës së Ligjit të AKP-së, pjesën e detyrimit në të holla, t'a realizoj te Autoriteti i Likuidimit në kuadër të AKP-së në Prishtinë.

Vendimin për shpenzimet e procedurës së përmbartimit në këtë çështje juridike të përmbartimit, kjo gjykatë e mori në kuptim të nenit 13 lidhur me nenin 450 të LPK-së pasi që secila palë paraprakisht vetë i bartë harxhimet që i ka shkaktuar me veprimet procedurale të veta.

Nga të thënat si më lartë, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi dhe në kuptim të nenit 3, 17, 71 par. 1 pika 1.10, 73 par.3 të LPP-së, si dhe lidhur me nenin 7, 10 dhe nenin 23 të Shtojcës së Ligjit nr.04/L-034 për Agjencinë Kosovare të Privatizimit (AKP).

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN

Departamenti i Përgjithshëm

Cp.nr.992/2023

Datë 28.03.2024

Gjyqtari
Sami Gashi

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi, pala e pa kënaqur ka të drejtë të paraqes ankesë brenda afatit prej 7 (shtatë) ditëve, pas ditës së pranimit të këtij aktvendimi, Gjykatës së Apelit të Kosovës në Prishtinë, nëpërmjet kësaj gjykate.